



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:197067

Datë: 07.10.2021

Numri i dokumentit: 02253947

P.nr.1012/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni–sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit T.K., nga Prizreni, me nr. personal, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1714-8/21 të datës 14.09.2021, për shkak të veprës penale, dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Naim Gashi, të akuzuarit, mbrojtësit të tij av.A.J., nga Prizreni, të dëmtuarave A.Gj., dhe A.K., me datë 28.09.2021, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.06.10.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

T.K., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur menë, tani jeton në Prizren, rr.””, nr....., ka të kryer gjashtë vite të shkollës fillore, i papunë, i martuar, i ati i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Më datën 02.09.2021 rreth orës 22:00, në Prizren, i akuzuari me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda një marrëdhënie familjare, ju shkakton dhunë psikologjike dhe fizike të dëmtuarave–bashkëshortes së tij A.Gj., dhe vajzës së tij A.K., si viktima të ndjeshme, ku i akuzuari i keqtrajton fizikisht dhe psiçikisht të dëmtuarat në këtë rast, ashtu që pasi të dëmtuarat e kishin parë të akuzuarin tek tregu i gjelbër duke konsumuar alkool me një femër tjetër, i akuzuari i revoltuar nga kjo rrethanë, me të ardhur në shtëpi në gjendje të dehur me 1.25 promil të alkoolit, fillimisht i kërkon të dëmtuarës A....., shumë e parave prej 20 Euro të cilat ja kishte dhënë më parë dhe pasi e dëmtuara i tregon se i ka shpenzuar këto para, i akuzuari i revoltuar tenton që ta sulmoj fizikisht, por në atë moment hynë në mes e dëmtuara A....., ku i akuzuari tenton që ta sulmoj edhe këtë të fundit, dhe në pamundësi për ti goditur të dëmtuarat, fillon ti keqtrajtoj psiçikisht duke i ofenduar me fjalë të ndryshme, e po ashtu duke kanosur me

fjalë të ndryshme, me të cilat veprime tek të dëmtuarat ka shkaktuar shqetësim të madh emocional dhe ndjenjë të frikës dhe pasigurisë.

-Këso dore kryen veprën penale, dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartshënuar dhe neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 43, 46 par.1 nënpar.1.1, 47, 48, 49, 69, 71, 79 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

DËNIMIN ME GJOBË

- Në shumë prej 600 € (gjashtëqind euro), në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 02.09.2021 e deri me datë 28.09.2021, ndërsa shumën e mbetur të dënimit me gjobë në shumën prej 60 (gjashtëdhjetë euro) i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

I akuzuari T.K., obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën 20 euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarat: A.Gj., dhe A.K., që të dyja nga Prizreni, Lagja, rr.”, nr....., nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1714-8/21 të datës 14.09.2021, kundër të akuzuarit T.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale, dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, qëndron në tërësi si në aktakuzën me PP.II.nr.1714-8/21 të dt.14.09.2021, duke pas parasysh se gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës u vërtetua edhe gjatë shqyrtimit fillestar në të cilin i pandehuri pranon në tërësi veprën për të cilën e ngarkon aktakuza. Andaj i ka propozuar gjyqtarës

gjykuese që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj konform dispozitave ligjore, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

E dëmtuara A.Gj., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, sa i përket rastit konkret këtu të akuzuarit-bashkëshortit të saj edhe këtë herë ia falë gabimin, e lut gjykatën që ta liroj nga paraburgimi, shton se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

E dëmtuara A.K., në prezencën e përfaqësueses ligjore ka deklaruar se, ia fal gabimin babait të saj me shpresë se në të ardhmen i njëjti nuk do të kryej veprime kundërligjore, shton se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av.A.J., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, fillimisht dëshiron që të dëmtuarve t'iu shpreh keqardhje për atë se çka ka ndodh. Sa i përket aktakuzës konsideron se aktakuza ka mbështetje të plotë në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, ka lutur gjykatën që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, gjendjen tejet të vështirë ekonomike të të akuzuarit, sjelljen e tij, posaçërisht pranimin e fajësisë dhe premtimin se një gjë e tillë nuk do të ndodhë më kurrë.

I akuzuari T.K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se publikisht u kërkon falje të dëmtuarve, bashkëshortes dhe vajzës së tij në këtë rast, me premtimin e plotë para gjykatës se në të ardhmen asnjëherë më nuk do të përsëritë veprime të tilla apo të tjera kundërligjore.

Gjykata në shqyrtimin fillestar nga pranimi i fajësisë dhe provat materiale, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari T.K., më datën 02.09.2021 rreth orës 22:00, në Prizren, i akuzuari me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda një marrëdhënie familjare, ju shkaktonte dhunë psikologjike dhe fizike të dëmtuarave—bashkëshortes së tij A.Gj., dhe vajzës së tij A.....Krasniqi, si viktima të ndjeshme, ku i akuzuari i keqtrajton fizikisht dhe psikikisht të dëmtuarat në këtë rast, ashtu që pasi të dëmtuarat e kishin parë të akuzuarin tek tregu i gjelbër duke konsumuar alkool me një femër tjetër, i akuzuari i revoltuar nga kjo rrethanë, me të ardhur në shtëpi në gjendje të dehur me 1.25 promil të alkoolit, fillimisht i kërkon të dëmtuarës A.Gj., e parave prej 20 Euro të cilat ja kishte dhënë më parë dhe pasi e dëmtuara i tregon se i ka shpenzuar këto para, i akuzuari i revoltuar tenton që ta sulmoj fizikisht, por në atë moment hynë në mes e dëmtuara A....., ku i akuzuari tenton që ta sulmoj edhe këtë të fundit, dhe në pamundësi për ti goditur të dëmtuarat, fillon ti keqtrajtoj psikikisht duke i ofenduar me fjalë të ndryshme, e po ashtu duke kanosur me fjalë të ndryshme, me të cilat veprime tek të dëmtuarat ka shkaktuar shqetësim të madh emocional dhe ndjenjë të frikës dhe pasigurisë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari T.K., i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë pas konsultimit me mbrojtësin e tij av.A.J., andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, keqardhjen e shprehur dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarave, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej veprime kundërligjore si dhe gjendjen e tij të dobët ekonomike, kurse në rastin konkret gjykata aplikoi nenin 71 të KP-së për zbutjen e dënimit, duke pasur parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari. Kështu që duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, është e pritshme të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KP-së dhe se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, përkatësisht parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL

2021:197067, 28.09.2021

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.